REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 45/23
Datë/Datum. 31.03.23
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 45/23

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga :Vedat Poterqoi Kryetar, Agon Ramadani Anëtarë si dhe Kimete Gashi Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "Shkëmbi" sh.p.k me seli në Istog, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dimërore e Rrugëve; Lot 1 - Mirëmbajtja e rrugëve në qytet , Lot 2 - Mirëmbajtja e rrugëve të fshatrave, Lot 3 - Mirëmbajtja e rrugëve të fshatrave të Rugovës" me numër të prokurimit: 635-22-11224-2-1-1, iniciuar nga AK Komuna e Pejës, me datën 30.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

1. **Aprovohet,** si e bazuar ankesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik "Shkëmbi" sh.p.k me seli në Istog e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 18.01.2023 (me numër protokolli 45/2023) për aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dimërore e Rrugëve; Lot 1 - Mirëmbajtja e rrugëve në qytet" me numër të prokurimit: 635-22-11224-2-1-1, iniciuar nga AK Komuna e Pejës.

2. **Anulohet,** B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 04.01.2023, për aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dimërore e Rrugëve; Lot 1 - Mirëmbajtja e rrugëve në qytet" me numër të prokurimit: 635-22-11224-2-1-1, iniciuar nga AK Komuna e Pejës, ndërkaq aktiviteti i prokurimit i lartë përmendur kthehet në **rivlerësim.**

3. Me qenë se ankesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik "Shkëmbi" sh.p.k aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 13.10.2023, Kuvendi Komunal Pejës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë për aktivitetit të prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dimërore e Rrugëve; Lot 1 -Mirëmbajtja e rrugëve në qytet , Lot 2 - Mirëmbajtja e rrugëve të fshatrave, Lot 3 - Mirëmbajtja e rrugëve të fshatrave të Rugovës" me numër të prokurimit: 635-22-11224-2-1-1,ku është rekomanduar për Loto 1 Grupi i Operatorëve Ekonomik "Er - Lis sh.p.k.; El-Bau sh.p.k Sinani - Ing sh.p.k.
Me datë 09.01.2023, Operatori Ekonomik "Shkëmbi" sh.p.k ,ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK- Kuvendi Komunal Pejës, me datë 13.01.2023 AK e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 04.01.2023
Me datën 18.01.2023 Operatori Ekonomik "Shkëmbi" sh.p.k ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 45/2023, kundër B58 Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të aktivitetit të prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës : Kontratën Publike Kornizë Shërbim , vlera e parashikuar e kontratës: 538.500,00 €

LOT I - 135.000.00 Euro

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 30 janar 2023 me raportin e ekspertizës. Me datë 20 janar 2023 AK Kuvendi Komunal Pejës nuk është deklaruar se a pajtohet a jo me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërsa me datë 30 janar 2023 OE "Shkëmbi" sh.p.k ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Po ashtu OE "ER-Lisi" sh.p.k me dt.06.03.2023 si palë e interesuar është përgjigj ne ekspertizën nr.45/23 të ekspertit shqyrtues i cili ka deklaruar se nuk pajtohet me ekspertizën eksperti shqyrtues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 20.01.2023, eksperti i jashtëm shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE "Shkëmbi" sh.p.k të aprovohet, si e bazuar.

- të anulohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK-së të datës 04.01.2023 ndërkaq aktiviteti i prokurimit me të dhënat sipër shënuar të kthehet në rivlerësim.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE"Shkëmbi" sh.p.k me seli në Istog

Pretendimi Nr.1

Lidhur me pretendimin e OE "Shkembi" sh.p.k – Istog se AK – Komuna e Pejës ka propozuar për kontratë grupin e OE " ER- LIS" sh.p.k. "EL-BAU" sh.p.k, "Sinani- ING" sh.p.k. i cili tek deklarata nën betim forma e Aneksit 2 të dosjes së tenderit nuk është e përmbushur ashtu siç kërkohet për liderin e grupit të operatorit ekonomik "Er-Lisi" sh.p.k, tek hapësira e (emrit të operatorit ekonomik) është e paplotësuar që nuk është e pranueshme një gjë e tillë, pra OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.

Përgjigjeje në pretendimin Nr.2

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE "Shkembi" sh.p.k – Istog duke u bazuar në faktet e prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim, sqaron se anëtar i "Er-Lisi" sh.p.k, i grupit të OE "Er-Lis" sh.p.k; "El-Bau" sh.p.k; "Sinani- Ing" sh.p.k, të propozuar për kontratë deklaratën nën betim e ka dorëzuar pa e shkruar emrin në rreshtin e parë të kësaj deklarate. Eksperti shqyrtues mendon se ky është një gabim minor sepse të deklarata nën betim ku është kërkuar identifikimi i operatorit ekonomik është shënuar emri e OE: "Er-Lisi" sh.p.k dhe është i mjaftueshëm identifikueshëm.

Shih DEKLARATËN NËN BETIM

Aneksi 2. **DEKLARATA NËN BETIM**

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar [illegible] deklaroj nën betim se jam i njoftohet me njoftimin e [illegible] Nr. 05/L-068 dhe ligji Nr. 05/L-092

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 te LPP-së, respektivisht paragrafin 6 "Informacioni për Pjesëmarrësit dhe Vërtetoj se i plotësoj kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje ne këtë procedure te prokurimit

Unë pranoj mundësinë e sanksioneve penale dhe civile, gjobave dhe dëmeve, nëse unë per shkak te pakujdesisë dorëzoj çfardëo dokumenti ose deklarata që përmbajnë informata penetrojëtëshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	ER-LIS SHPK
Adresa e plotë:	BBI-Vitomirice Peje
I përfaqësuar nga:	
Emri	Shpetim Morina
Pozita	Drejtor
Nënshkrimi	
Data	23.12.2022
Vula	ER-LIS

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i bazuar

Pretendimi Nr.2

Lidhur me pretendimin e OE "Shkembi" SH.P.K se AK – Komuna e Pejës ka propozuar për kontratë grupin e OE "ER – LIS" SH.P.K.; "EL-BAU" SH.P.K.; "SINANI- ING" SH.P.K., i cili te krijimi i grupit të operatoreve ekonomik i mungon deklarata ku dëshmon se të gjithë pjesëmarrësit e grupit janë të përshtatshëm dhe i përmbushin kërkesat e dosjes së tenderit, ndërsa deklaratat dhe marrëveshja e grupit të OE të rekomanduar për kontratë (konzorciumit) janë të ngarkuara në formë, kopje të skanuar dhe nuk janë të formuluara në formën e duhur.

Përgjigjeje në pretendimin Nr.2

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE "Shkembi" sh.p.k Istog duke u bazuar në faktet e prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se, AK -ja me dosjen e tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) me nenin 11.1 Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik ka kërkuar në piken d.) Të gjitha anëtarët e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.

Eksperti shqyrtues sqaron se Grupi i OE marrëveshjen e krijimit të grupit në mes të OE "Er- Lis" sh.p.k.& "El-Bau" sh.p.k & "Sinani- Ing" e ka prezantuar me ofertë në kopje si dhe pika d.)Të gjitha anëtarët e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT. nenin 11.1 Krijimi i

një grupi të operatorëve ekonomik të kërkuar me dosjen e tenderit tek FDT i mungon në krijimin e grupit, dhe nuk plotësohet paragrafi 6,4 e FDT të kërkuar me dosjen e tenderit. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi Nr.3

Lidhur me pretendimin e OE "Shkembi" sh.p.k se AK – Komuna e Pejës OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit përkatësisht tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. 9.1 & 9.2, Kapaciteti teknik dhe profesional, tek Kërkesa 7 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se sistemi manaxhues i ofertuesit përmbush kriteret e përcaktuara në fushën e ndërtimit të rrugëve së paku për këto ISO standarde -ISO 39001 2012 - Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor, ndërsa si dëshmi është kërkuar Certifikatat valide për ISO standardet e kërkuara në fushën e ndërtimit të rrugëve, të skanuara nga origjinali. Grupi i Operatoreve ekonomik të shpallur fitues nuk e plotëson kërkesën sepse në ofertë kanë prezantuar kopje të noterizuar të skanuar dhe atë vetëm anëtari i 3-të i grupit SINANI ING , ndërsa sipas Ligjit të ri të prokurimit të përditësuar kërkohet që edhe në rast të konzorciumit të gjithë anëtaret ti kenë dhe ti paraqesin ISO-të

Përgjigjeje në pretendimin Nr.3

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE "SHKEMBI" SH.P.K –Istog duke u bazuar në faktet e prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se AK -ja ka kërkuar me njoftimin për kontrate dhe dosjen e tenderit të kriteret për vlerësim respektivisht të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. 9.1 & 9.2, Kapaciteti teknik dhe profesional, tek Kërkesa 7 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se sistemi manaxhues i ofertuesit përmbush kriteret e përcaktuara në fushën e ndërtimit të rrugëve së paku për këto ISO standarde -ISO 39001 2012 - Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor, ndërsa si dëshmi është kërkuar Certifikatat valide për ISO standardet e kërkuara në fushën e ndërtimit të rrugëve, të skanuara nga origjinali.

Eksperti shqyrtues sqaron se grupi i operatoreve ekonomik i propozuar për kontratë "ER-LIS" sh.p.k.& "El-Bau" sh.p.k. & "Sinani- Ing" sh.p.k me ofertën e tij ka prezantuar ISO standarde ISO 39001 2012 -Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor me Vlefshmëri të certifikatës lëshimi i parë 19/08/2022 dhe datë të skadences 18/08/2025 në kopje të noterizuar në emër të Kompanisë "Sinani- Ing" sh.p.k me numër LRP nr. 10843/2022 të datës 06.09.2022 nga Noter Ma. Sc. Arbena Shehu e cila i plotëson kriterin e kërkuar. Mirëpo nuk i ka paraqitur ISO standardet dhe për anëtaret tjerë të grupit dhe të cilat duke u bazuar në Rregulloren Nr.001/2022 për Prokurimin Publik Neni 26 Grup i Operatorëve Ekonomik, paragrafi, 26.6 Certifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde Kosovare, Evropiane ose

Ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar

Pretendimi Nr.4

Lidhur me pretendimin e OE "Shkembi" SH.P.K se AK – Komuna e Pejës OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit përkatësisht tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. 9.1 & 9.2, Kapaciteti teknik dhe profesional, tek Kërkesa 6, është kërkuar Plani i menaxhimit dhe pastrimit sa më i detajuar, Plani dinamik sa më i detajuar (gantogrami), ndërsa si dëshmi është kërkuar Plani i menaxhimit dhe pastrimit sa më i detajuar, origjinal i nënshkruar. Plani dinamik sa më i detajuar (gantogrami), origjinal i nënshkruar.

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se plani i menaxhimit të trafikut sa më i detajuar ashtu siç është përcaktuar në kërkesë nuk është prezantuar në ofertë dhe si i tillë OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm. Po ashtu i njëjti OE është i papërgjegjshëm edhe për faktin se plani dinamik është i nënshkruar dhe vulosur vetëm nga Lideri i Grupit "ER-LIS" sh.p.k dhe jo nga të gjithë anëtarët e konsorciumit.

Përgjigjeje në pretendimin Nr.4

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE "Shkembi" sh.p.k Istog duke u bazuar në faktet e prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se AK -ja ka kërkuar me njoftimin për kontrate dhe dosjen e tenderit te kriteret për vlerësim respektivisht te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. 9.1 & 9.2, Kapaciteti teknik dhe profesional, tek Kërkesa 6, është kërkuar Plani i menaxhimit dhe pastrimit sa më i detajuar, Plani dinamik sa më i detajuar (gantogrami), ndërsa si dëshmi është kërkuar Plani i menaxhimit dhe pastrimit sa më i detajuar, origjinal i nënshkruar. Plani dinamik sa më i detajuar (gantogrami), origjinal i nënshkruar.

Eksperti shqyrtues sqaron se grupi i operatoreve ekonomik i propozuar për kontratë "Er-Lis" sh.p.k.& "El-Bau" sh.p.k & "Sinani- Ing" sh.p.k, pas analizës se dokumentacionit të dorëzuar me ofertë nuk e ka prezantuar plani i menaxhimit të trafikut, ndërsa sa i përket Planit dinamik Grupi i OE e ka dorëzuar por jo të detajuar siç është kërkuar me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi Nr.5

Lidhur me pretendimin e OE "Shkembi" sh.p.k se AK – Komuna e Pejës OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit përkatësisht tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. 9.1 & 9.2, kërkesa Nr. 9, është kërkuar Specifikimi teknik i detyrueshëm, ndërsa si dëshmi është kërkuar Deklarata e

O.E (e nënshkruar dhe e vulosur) mbi pranimin e specifikimeve teknike të detyrueshme të dhëna nga A.K.

OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se deklarata mbi pranimin e specifikimeve teknike të detyrueshme është e paraqitur vetëm nga Lideri i Grupit. Deklarata duhet të jetë e përbashkët dhe të jetë e vulosur dhe e nënshkruar nga të gjithë anëtaret e grupit. Po ashtu mungon pjesa e dosjes se tenderit të bashkangjitur ANEKSIN 1, të nënshkruar dhe të vulosur gjithashtu nga të gjithë anëtarët e grupit, gjithashtu edhe Paramasa e tenderit në fjalë është e nënshkruar dhe e vulosur vetëm nga lideri Grupit.

Përgjigjeje në Pretendimin Nr.5

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE "Shkembi" sh.p.k Istog duke u bazuar në faktet e prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se AK -ja ka kërkuar me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit të kriteret për vlerësim respektivisht të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. 9.1 & 9.2, kërkesa Nr. 9, është kërkuar Specifikimi teknik i detyrueshëm, ndërsa si dëshmi është kërkuar Deklarata e O.E (e nënshkruar dhe e vulosur) mbi pranimin e specifikimeve teknike të detyrueshme të dhëna nga A.K.

Eksperti shqyrtues sqaron se grupi i operatoreve ekonomik i propozuar për kontratë "Er-Lis" sh.p.k.&"El-Bau" sh.p.k.& "Sinani-Ing" sh.p.k me ofertën e tij ka prezantuar specifikimin teknik të detyrueshëm i cili është i nënshkruar vetëm nga Lideri i grupit "Er-Lisi" sh.p.k, eksperti shqyrtues sqaron se në marrëveshjen për themelimin e grupit është Autorizuar z. Shpetim Morina drejtor ligjor i "Er –Lisi" sh.p.k që në emër të grupit të kryej nënshkrimin e tenderit dhe të gjitha obligimeve tjera që rrjedhin nga kontrata e mundshme.

Eksperti shqyrtues sqaron se si pasoj e mungesës së nënshkrimit elektronik sipas Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik neni 27-Dosja e Tenderit, paragrafi 17.9 Gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të tenderëve, OE nuk duhet të nënshkruajnë manualisht formularin e tenderit (i cili gjenerohet nga sistemi) dhe listën e çmimeve, pavarësisht se a është përdorë Lista e çmimeve standarde ose jo-standarde.

Ndërsa sa i përket prezantimit të marrëveshjes së themelimit të grupit i cili është dorëzuar kopje AK –ja duhet të veproj në bazë të LPP-se; Nenit 72- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, paragrafi 3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pjesërisht bazuar.

Pretendimi Nr.6

Lidhur me pretendimin e OE "Shkembi" sh.p.k se AK – Komuna e Pejës OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së

tenderit përkatësisht tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. 9.1 & 9.2, kërkesa 1. Është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat në mirëmbajtje ose rehabilitim të rrugëve në vlerë jo me pak se 200,000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjashme të realizuara në 3vitet e fundit, ku si dëshmi është kërkuar Lista e kontratave duhet të dorëzohet e skanuar nga origjinali - e nënshkruar dhe vulosur nga O.E., duke specifikuar emrin e projektit, shumën kontratës, datën e mbarimit të kontratës dhe referenca apo raporte të pranimit teknik të pjesshëm ose përfundimtar. Referencat apo raportet e pranimit teknik duhet të korrespondojnë me listën e kontratave.

OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se në ofertë ka prezantuar si dëshmi disa referenca të cilat nuk korrespondojnë me listën e kontratave të ofruara ose në listë të kontratave është paraqitur ndërsa si referenca mungojnë.

Si dhe disa referenca nga kompani të ndryshme për punë të kryera që nuk janë të vërtetuara me dëshmi të pagesës bankare.

Po ashtu e disa kontrata janë të lëmisë tjetër dhe jo mirëmbajtje të rrugëve ose rehabilitim siç kërkohet në dosje të tenderit, andaj duke u bazuar në këto fakte kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të konsiderohet edhe nga AK-ja dhe jo të rekomandohet për kontratë.

<u>Përgjigjeje në pretendimin Nr.6</u>

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE "Shkembi" sh.p.k Istog duke u bazuar në faktet e prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se AK -ja ka kërkuar me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit te kriteret për vlerësim respektivisht të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. 9.1 & 9.2, kërkesa 1. Është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat në mirëmbajtje ose rehabilitim të rrugëve në vlerë jo me pak se 200,000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjashme të realizuara në 3vitet e fundit

Eksperti shqyrtues sqaron se udhëheqësi i grupit të operatoreve ekonomik i propozuar për kontratë "ER- LIS" me ofertën e tij ka prezantuar listën e kontratave.

	Lista e kontratave OE "ER LIS) SH.P.K.			Kontrata e realizuara ne tri vitet e fundit prej 13.10.2019 deri 13.10.2022				
N	Titulli i kontratës	Data e nënshkrimit	Data	Vlera totale e kontratës	Emri i Blerësit	Numri i Kontratës	Ref

				Kontratat qe nuk e plotesojn kriterin	E ploteson kriterin (eshte llogaritur periudha e vlefshmeris se kontrates)				
1	Mirem e rrjetit te ujesje. Dhe kanaliz pastrimi i rugeve,ujitja e hapsirave publike dhe transporti i mbeturinave Prej (19.06.2017 - 19.06.2020)	Kontrata NR 6120/16/097/221 19.06.2017	19.06.2020	121,361.00	40,453.67	Komuna Fushe Kosove	049 831 458	PO	17.12.2020
2	Mirembajtja dimerore e rrugeve te KEK-ut (skadon tre vite pas nenshkrimit te kontrates)	KEKO-16-331-221 19.01.2017	27.01.2019	36,257.58	12,085.86	Koorporata Energjetike KEK	045 898 124	PO	19.06.2020
3	Mirembajtja dimerore e rrugeve ne komunen e Pejes LOT 1	16019-16-113-221 29.09.2017	29.09.2020	77,956.20	25,985.40	Komuna Peje	045 110 802	PO	07.12.2020
4	Mirembajtja dimerore e rrugeve ne komunen e Pejes LOT 1	635-20-7698-2-1-1 24.12.2020	24.12.2021	30,600.00		Komuna Peje	045 110 802	PO	JO
5	Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal	644-18-227-121 06.04.2020	04.04.2022	69,974.90		Komuna Vushtrri	044 213 287		17.12.2021
6	Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal ne komunen e Istogut	633-19-005-2-2-1	24.09.2021	60,000.00		Komuna Istog	044 281 743	JO	23.03.2021
7	Rekonstruimi i rruges Hasan Remniku – Prishtine	Nentor 2020	2021	17,500.00		LEDI ING	049 864 222	JO	JANAR 2020
8	Ndertimi i platformave per kembesor ne rruget-Peje	2019	2019	10,545.50		BKConstruction shpk	044 110 802	JO	15.05.2019

9	Sinjalizimi i rrugesB ne Prishtine	2022	2022	6,000.00		Malsia SHPK	044 138 996	JO	JO
10	Sinjalizimi i parkingjeve,punimi konstrukcioneve te hekurit ne Aldex Peje-Prishtine dhe Peje	2021	2022	28,000.00		ALDEX	045 581 331	JO	19.08.2022
11	Punimi,montimi dhe lyerja e tropozonave te shkalleve	2022	2022	1,475.00		DEVOLLI CORPORATION SHPK	044 148 055	JO	JO
12	Shenjezimi horiz. ne rrugen Kisha Deqan	2021	2022	2,217.00		NTP Bashkimi-HG	049 417 838	JO	JO
13	nrp: Mirembajtja e rrugeve te KEK-ut gjate sezones dimerore (36 MUAJ)	KEKO -19-415-221 DT 03.02.2020	2022	28,019.10		keko-19-415-211 Koorporata Energjetike KEK	045 898 124	PO	JO
14	Mirembajtja e hapesirave publike te rrugeve dhe trotuareve ne viset rurale	616-20-106-5-2-1 04.11.2020	2021		31,796.79	Komuna e Prishtines	045 071 41	PO	18.05.2022
	Shuma e kontratave të realizuara gjatë tri viteve të fundit pas publikimit të njoftimit për kontratë (prej 13.10.2019 deri 13.10.2022).				**110,321.72**				

Duke u bazuar në listën kontratave të propozuar me ofertë nga udhëheqësi i grupit të OE të propozuar për kontratë nuk e plotëson kriterin të kërkuar me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. 9.1 & 9.2, kërkesa 1. Është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat në mirëmbajtje ose rehabilitim të rrugëve në vlere jo me pak se 200,000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit. Eksperti shqyrtues mendon se për kontratën: Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Pejës LOT 1 me numër të prokurimit: 635-20-7698-2-1-1 e datës 24.12.2020 AK- Komuna e Pejës, për këtë kontratë Autoriteti Kontraktues respektivisht komisioni për vlerësim të ofertave të veproj konform LPP-së; Nenit 72- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, paragrafi 3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive, sepse udhëheqësi i grupit të OE me ofertën e tij ka prezantuar kontratën për kryerjen e këtij aktiviteti, mirëpo se ka prezantuar referencën për përfundimin e këtij aktiviteti por ka propozuar dy referenca të njëjta për aktivitetin e prokurimit: Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Pejës LOT 1 me numër të prokurimit: 16019-16-113-221 të datës 29.09.2017 të

lëshuara nga AK- Komuna e Pejës. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pjesërisht bazuar.

Pretendimi Nr.7

Lidhur me pretendimin e OE "Shkembi" sh.p.k se AK – Komuna e Pejës, OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit përkatësisht kërkesën tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. 9.1 & 9.2, Kapaciteti teknik dhe profesional, tek Kërkesa 8, Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit ne dosje të tenderit tek Aneksi 1.

OE të rekomanduar për kontratë ne kemi ardhë në përfundim që i njëjti nuk e plotëson edhe kërkesën e lartcekur të dosjes së tenderit, pasi që të njëjti i nuk vërteton me dëshmi njërën nga makineria në listë, por paraqet si dëshmi faturë me përshkrim të makinerisë tjetër, me konkretisht tek ngarkuesi me kapacitet 3 m3

Sa i përket kërkesës ku është kërkuar Ngarkues me kapacitet min. 3 m3, DUD-i i prezantuar për të njëjtit nuk korrespondon me faturën e cila është prezantuar me rastin e ofertimit me kompaninë e paraqitur sh.a Magjistrala. Në faturë është shënuar emërtimi për Liebherr R-914 viti prodhimit 2000, ndërsa në DUD viti i prodhimit 1988.

Përgjigjeje në pretendimin Nr.7

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE "Shkembi" sh.p.k Istog duke u bazuar në faktet e prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se AK -ja ka kërkuar me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit te kriteret për vlerësim respektivisht te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. 9.1 & 9.2, kërkesa 8, Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit ne dosje të tenderit tek Aneksi 1.

Eksperti shqyrtues sqaron se grupi i operatoreve ekonomik i propozuar për kontratë "ER-LIS" sh.p.k.& "El-Bau" sh.p.k & "Sinani- Ing" sh.p.k me ofertën e tij për: Ngarkues me kapacitet min. 3 m3 – sasia e kërkuar -1, ka prezantuar kontratën.

KONTRATE

Mbi shit-blerjen

Me 23.10.2015

1. Shpk "Magjistralja" Gjilan me nr te biznesit 70333943 te cilin e perfaqeson drejtori Avdil Pireva nga Gjilani, shites nga njera ane

2. "EL BAU" shpk Gjilan me nr te biznesit 70811499 te cilin e perfaqeson drejtori Suad Pireva nga Gjilani, bleres nga ana tjeter,

Neni 1

Lenda e kesaj kontrate eshte shitblerja e Ngarkuesit me goma I perdorur, Tip Libebher – 541, Nr. I shasise L - 541289 – 667, viti I prodhimit 1988.

Si dhe Dudin Unik Doganor sipas: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 kërkesa 8. për LOT 3 Dëshmia: ..... Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit, ndërsa pajisjet tjera, OE duhet ti dëshmojë me një dokument për pronësinë e tyre (faturë, DUD etj).


DOKUMENTI UNIK DOGANOR

3 8

LIEBHERR WERK BISCHOFEN
A8/5500 Bischofen/Austria

000987800174643

SH.A. " MAGJISTRALJA "
Prishtinë/Kosovo

000087
" Kosovashped " Prizren

DR-59190/DR-74250 AL

EXW Bischofshofen

EUR 5.000,00

51/ 1.500 eur.

0009 CP LB

Ngarkues me goma I perdorur, Tip LIEBHERR L-541, Njësia vërtetësiv i I prodhimi 1988, nr. i shasisë: L-541289-667.

13.000

534/2003

Këto dy dokumente të prezantuara nga grupi i OE i propozuara për kontratë janë dokumente të cilat e specifikojnë të njëjtën pajisje 62 e cila është kërkuar nga AK-ja. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertit Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa: "SHKEMBI" SH.P.K ankues të merret si e bazuar, dhe rekomandojmë që Autoriteti Kontraktues të bëjë ANULIMIN - B58 Njoftim për Vendimin e Autoriteti Kontraktues dhe lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

- Konstatimet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor me dt. 21.03.2023 me qëllim të vlerësimit të drejtë të çështjes. Pohimet e palëve, provat e administruara dhe shpjegimet e ekspertit janë evidentuar në procesverbalin e kësaj seance, të cilat në ketë rast për nevojat e këtij vendimi konstatohet (shkurtimisht) se, të dyja palët kanë qëndruar prapa pretendimeve të tyre.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij paneli dhe si rrjedhojë paneli sqaron se:

Lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues kundrejt Grupit të OE të rekomanduar për kontratë "ER-LIS" sh.p.k.& "El-Bau" sh.p.k. & "Sinani- Ing" sh.p.k, Paneli Shqyrtues konstaton se në trajtimin e kësaj ankese do të ndalet tek pretendimi ankimor 3, sa i përket ISO 39001 2012 - Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor, si pikë kyçe e cila përcakton rrjedhën e vendim-marrjes përfundimtare, andaj PSH nuk e konsideron të nevojshme që pretendimet tjera lidhur me këta OE të shqyrtohen në detaje.

Këtë pretendim ankimor, PSH e klasifikon si të bazuar dhe e mbështet mendimin dhe arsyetimin e Ekspertit shqyrtues i cili sqaron se grupi i operatoreve ekonomik i propozuar për kontratë "ER-LIS" sh.p.k.& "El-Bau" sh.p.k. & "Sinani- Ing" sh.p.k me ofertën e tij ka prezantuar ISO standarde ISO 39001 2012 -Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor, mirëpo nuk i ka paraqitur ISO standardet dhe për anëtaret tjerë të grupit dhe të cilat duke u bazuar në Rregulloren Nr.001/2022 për Prokurimin Publik Neni 26 Grup i Operatorëve Ekonomik, paragrafi, 26.6 Certifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde Kosovare, Evropiane ose Ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar dhe me ç'rast OE të rekomanduar për kontratë e bënë të papërgjegjshëm.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59, 60 dhe 70 të LPP. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet jo konform akteve ligjore të AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur me plotësimin ose jo të kushteve të

përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehen sërish në ri-vlerësim sepse, në të kundërtën kjo do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP.

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Paneli shqyrtues me marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkoj ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Vendimi sikurse në pikën 3, të dispozitivit është marrë ne kuptim te nenit 31, paragrafi 6, i Rregullores se punës se Organit Shqyrtues të Prokurimit

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Komuna e Pejës
1x1 OE "Shkëmbi" sh.p.k me seli në Istog
1x1 Arkivës së OSHP-së;
1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.